



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 163, datë 18.05.2021

**PËR SHPALLJEN E 2 (DY) VENDEVE VAKANTE PËR NGRITJEN NË DETYRË TË PROKURORËVE NË PROKURORINË E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Në përputhje me nenin 6 dhe nenin 7 të Ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", nenit 159 pika 2 germa "a", 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, 190 të ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar si dhe nenet 47 dhe 48 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimin Nr. 6/2021 të Kuvendit "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të prokurorëve në prokurorinë e posaçme", Rregulloren "Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar", miratuar me vendim nr. 51, datë 19.03.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**VENDOSI:**

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 2 (dy) vendeve vakante për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) përmes procedurës së ngritjes në detyrë.
2. Njoftimi i vendeve vakante si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët do të publikohen në faqen zyrtare të institucionit.
3. Shprehja e interesit duhet të dorëzohet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga shpallja e thirrjes në faqen zyrtare të institucionit dhe të dorëzohet në adresën:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga "Ana Komnena", godina Poli i Drejtësisë, Ish Fusha e Aviacionit, Tiranë.

Mbi zarf duhet të shënohet: "Shprehje Interesi për prokuror për në SPAK".

Gjithashtu mund të dorëzohet dhe në formë elektronike në adresën: [karriera@klp.al](mailto:karriera@klp.al) (në këtë rast të gjitha dokumentat duhet të jenë të skanuara bashkëlidhur kërkesës për aplikim).

Shprehja e Interesit duhet të përmbajë shpjegimet e kandidatit për arsyet e kandidimit (letra e motivimit jo më shumë se 3 faqe A4).

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare të Këshillit.



**KRYETARI**  
**GENT IBRAHIMI**